



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 05/L -080

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-034 PËR
AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR DHE
PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-115**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 04/L-034
PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT, I NDRYSHUAR
DHE PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 04/L-115**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 19 / 21 shtator 2011), i cili është ndryshuar dhe plotësuar me Nenin 4 të Ligjit Nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 25 / 07 shtator 2012), në tekstin e mëtejme: Ligji.

Neni 2

Neni 12 i Ligjit bazik, riformulohet si vijon:

Neni 12 Përbërja e Bordit

1. Bordi përbëhet nga tetë (8) Drejtorë.
2. Kuvendi i Kosovës, me propozim të Qeverisë, emëron Drejtorët e Bordit, duke përfshirë një përfaqësues nga komunitetet joshumicë si dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve.
3. Kuvendi, me propozimin e Qeverisë, nga radhët e anëtarëve të Bordit cakton Kryesuesin e Bordit
4. Bordi, emëron zëvendëskryesues të Bordit, njërin prej anëtarëve të tij.
5. Asnjë person nuk mund të bëhet ose të mbetet Drejtor nëse:
 - 5.1. është dënuar për kryerje të ndonjë vepre penale.
 - 5.2. është përjashtuar ose suspenduar nga ushtrimi i mëtutjeshëm i profesionit të tij për shkak të shkeljeve të rënda profesionale në pajtim me legjislacionin në fuqi.
 - 5.3. ka interes apo pretendim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në apo kundër një ndërmarrje ose në një person apo subjekt i cili pretendon apo pohon një interes apo pretendim; dhe
 - 5.4. ka interesa ose angazhohet në veprimtari të cilat janë në kundërshtim me përgjegjësitë e tij sipas nenit 15 të këtij ligji.
6. Për të pasur të drejtën e zgjedhjes si Drejtor, personi duhet të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në fushën e administratës publike, drejtësi, kontabilitet, financa dhe punë menaxheriale.
7. Bordi emëron Drejtorin e Sekretarisë Ekzekutive të Bordit, i cili nuk do të jetë anëtar i Bordit. Për emërimin, shkarkimin ose ndryshimin e kushteve të referimit të Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Bordit kërkohet vota afirmative e shumicës së Bordit.
8. Drejtori menaxhues dhe dy zëvendësdrejtorët menaxhues nuk janë anëtar të Bordit.

Neni 3

1. Neni 14, paragrafi 4 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

4. Bordi ka kuorum nëse janë të pranishëm së paku pesë (5) drejtorë.

2. Neni 14, paragrafi 7 i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

7. Për vendimet të cilat duhet të bëhen sipas nenit 15, nevojitet shumica e kualifikuar, vendimi do të merret me së paku pesë (5) vota pro.

3. Neni 14, paragrafi 9 i Ligjit bazik fshihet.

Neni 4

Neni 15, nën-paragrafi 2.3. i Ligjit bazik riformulohet si vijon:

2.3. emërimi apo shkarkimi i Drejtorit Menaxhues, Zëvendësdrejtorit Menaxhues ose të ndonjë zyrtari tjetër;

Neni 5

Neni 31, paragrafi 5 i Ligjit bazik fshihet.

Neni 6 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -080
14 dhjetor 2015**

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI